



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim
Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 prill 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden
Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Isni Kilaj ("z. Kilaj" ose "i akuzuari") u arrestua në Kosovë,² në bazë të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar proprio motu nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake,³ dhe në vijim konfirmimit të aktakuzës kundër tij, Hashim Thaçit, Fadil Fazliut, Bashkim Smakajt dhe Hajredin Kuçit ("Vendimi i konfirmimit").⁴

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#), (Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00043, Administratorja, [Notification of Arrest of Isni Kilaj Pursuant to Rule 55\(4\)](#), (Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik.

³ KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi për Arrestim"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#). Prokurorja e Specializuar i kishte kërkuar Gjykatësës së Procedurës Paraprake të ndërpriste lirimin me kusht të z. Kilaj dhe të urdhëronte kthimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. *Shih* KSC-BC-2023-12, F00023, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00022*, 17 tetor 2024, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 22, me Shtojcat 1, 3, 5, konfidenciale, dhe Shtojcat 2, 4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 27 nëntor 2024, F00023/SCONF/RED; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 dhjetor 2024, [F00023/RED](#).

⁴ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

2. Më 9 dhjetor 2024, në seancën e paraqitjes së parë të z. Kilaj,⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij ("Vendimi për Paraburgim").⁶
3. Më 28 janar 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi Vendimin e Paraburgimit.⁷
4. Më 7 shkurt 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj, ("Vendimi i Parë i Rishikimit").⁸
5. Më 10 mars 2025, Mbrojtja e z. Kilaj ("Mbrojtja e Kilajt") bëri parashtrime lidhur me rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Kilaj ("Parashtrimet e ZPS-së").⁹
6. Më 21 mars 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj parashtrimeve të Mbrojtjes.¹⁰ Mbrojtja e Kilajt u kundërpërgjigj më 28 mars 2025.¹¹

⁵ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, 9 dhjetor 2024 ("Transkripti i Paraqitjes së Parë"), publik, f. 85-125. Paraqitja e Parë e z. Kilaj u caktua fillimisht më 8 dhjetor 2024, por u shty më 9 dhjetor 2024 në bazë të kërkesës së mbrojtësit të tij. *Shih* KSC-BC-2023-12, F00059, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Setting the Date for Initial Appearances and Related Matters](#), (Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të) 6 dhjetor 2024, publik; F00063, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Rescheduling Initial Appearance of Isni Kilaj](#), (Vendim mbi Ricaktimin e Datës së Paraqitjes së Parë për Isni Kilajn) 7 dhjetor 2024, publik.

⁶ *Shih*, Transkripti i Paraqitjes së Parë, f. 120, rreshti 20 deri në f. 124, rreshti 23.

⁷ KSC-BC-2023-12, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Decision on Continued Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit për Vazhdimin e Paraburgimit), ("Vendimi mbi Apelin e Kilajt kundër Paraburgimit"), 28 janar 2025, publik.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00162, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Isni Kilaj](#), (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt), 7 shkurt 2025, publik.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00208, Mbrojtja e Kilajt, *Parashtrime të Mbrojtjes së Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit*, 10 mars 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 mars 2025, F00208/RED.

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00234, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit* ("Përgjigjja e ZPS-së"), 21 mars 2025, konfidenciale.

¹¹ KSC-BC-2023-12, F00244, Mbrojtja e Kilajt, *Kundërpërgjigje ndaj "Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Kilajt në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit"*, ("Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes"), 28 mars 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 1 prill 2025, F00244/RED.

II. PARASHTRIME

7. Mbrojtja e Kilajt parashtron se vazhdimi i paraburgimit të Kilajt nuk është më i arsyeshëm ose proporcional, dhe se rreziqet nga neni 41(6)(b) i Ligjit janë zvogëluar dhe mund të zvogëlohen mjaftueshëm përmes vendosjes së kushteve të rrepta për lirimin me kusht të z. Kilaj.¹² Në mbështetje të kësaj, Mbrojtja e Kilajt parashtron se: (i) koha e gjithsejtë që z. Kilaj ka kaluar në paraburgim (pothuajse dhjetë (10) muaj) dhe në liri me kusht (pothuajse shatë (7) muaj), me gjasë është më e gjatë se dënimi që mund të jepet në rast si ai shpallet fajtor në gjykim;¹³ dhe (ii) provat e nxjerra kohët e fundit vënë në dukje se sjellja e pretenduar e z. Kilaj është shumë më pak e rëndë se sa kishte deklaruar ZPS-ja në fillim, dhe tregon në mënyrë konkrete se në asnjë moment z. Kilaj nuk bëri përpjekje për të penguar ecurinë e procesit dhe nuk komunikoi me asnjë dëshmitar të ZPS-së në lidhje me dëshminë ose bashkëpunimin e tyre me ZPS-në.¹⁴

8. ZPS-ja përgjigjet se mbajtja në paraburgim e z. Kilaj vazhdon të jetë e domosdoshme dhe proporcionale.¹⁵ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se asnjë prej pikave të ngritura nga Mbrojtja e Kilajt nuk përbën ndryshim relevant të rrethanave që do të bënte më pak të rëndësishme domosdoshmërinë e mbajtjes së tij në paraburgim, dhe se nuk ka pasur asnjë informacion ose zhvillim të ri kundërshtues që nga Vendimi i Parë mbi Paraburgimin që do të ndikonte në konstatimet e

¹² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2, 5, 29, 40; Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 6, 14-15. Sa u përket kushteve të lirimit të përkohshëm, Mbrojtja e Kilajt u referohet në përgjithësi kushteve të vendosura nga Gjykatësi i Vetëm në kohën e urdhrit për lirim me kusht të z. Kilaj në maj 2024, përfshirë pagesën e një garancie në shumën prej 40,000 euro, dhe shton se z. Kilaj ka treguar më parë se është në gjendje dhe i gatshëm të respektojë këto kushte me përpikëri. *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 2, 25-29; Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 7, 10, 12. Mbrojtja e Kilajt shton se, edhe nëse Kilaj dënohet për veprën penale më të rëndë të tentativës së pengimit, për të cilën mund të dënohet me një (1) deri në pesë (5) vjet burgim, dënimi me gjasë do të jetë i ulët duke pasur parasysh se: (i) nuk pati pengim faktik; dhe (ii) z. Kilaj nuk komunikoi me dëshmitarë të ZPS-së me synimin për të ndërhyrë në dëshminë e tyre. *Shih* Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 27; Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, para. 7-10.

¹⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3-5, 27, 30-40; Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes, para. 8-10.

¹⁵ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 1, 6, 11.

mëparshme të Gjykatës së Procedurës Paraprake.¹⁶ Përkundrazi, ZPS-ja parashtron se, me ecurinë e fazës paraprake që vijon në mënyrë të shpejtë, janë shtuar rreziqet nga neni 41(6)(b) i Ligjit.¹⁷

9. Në lidhje me proporcionalitetin, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja e Kilajt shtrembëron standardin ligjor dhe bën parashtrime të pavend duke krahasuar situatën e Kilajt me atë të akuzuarve të tjerë që kanë pranuar fajësinë, dhe duke deklaruar se nëse shpallet fajtor ai ka të drejtën e uljes së dënimit.¹⁸ Së fundi, duke u përgjigjur parashtrimeve të Mbrojtjes së Kilajt në lidhje me provat e nxjerra kohët e fundit, ZPS-ja parashtron se vlera provuese, fuqia, cilësia dhe besueshmëria e provave janë çështje që diskutohen në gjykim dhe se rishikimi i paraburgimit sipas nenit 41(6) të Ligjit nuk është vendi i duhur për të bërë këtë vlerësim.¹⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

10. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, Dhomat e Specializuara ("DHS") urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur: (a) ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose do të pengojë ecurinë e procedurës penale përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëfajtorët; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të çojë deri në fund një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

¹⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2-3.

¹⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 3, 8.

¹⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 6-7.

¹⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 9. Në këtë aspekt, ZPS-ja shton se Mbrojtja e Kilajt paraqiti po këtë argument në apelin e saj kundër Vendimit për Paraburgim, që u hodh poshtë nga Paneli i Gjykatës së Apelit. *Shih* Përgjigjen e ZPS-së, para. 9, që i referohet [Kilaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimit të Apelit të Kilajt mbi Paraburgimin), para. 41.

11. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen, shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

12. Sipas nenit 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedurës penale, nga DHS-ja mund të urdhërohen masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masa alternative shmangëse. Sipas rregullës 56(5) të Rregullores, paneli mund të caktojë kushte që i gjykon të përshtatshme për lirim për të garantuar praninë e personit të paraburgosur.

13. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

14. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit, ajo ka detyrimin të shqyrtojë çdo dy (2) muaj nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje

në paraburgim,²⁰ përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht: (i) nëse ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale nga neni 41(6)(a) i Ligjit; dhe (ii) nëse ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ndonjë prej rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.²¹ Detyrimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë ende rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi i imponon Gjykatës së Procedurës Paraprake detyrën që të vlerësojë, proprio motu, nëse në kohën e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të çështjes kur bëhet rishikimi, është ende e bindur se paraburgimi i të akuzuarit vazhdon të jetë i përligjur.²² Ky rishikim i rregullt çdo dy (2) muaj nuk kufizohet rreptësisht me ndryshimin apo jo të rrethanave, por një ndryshim i tillë mund të jetë përcaktues dhe merret parasysh nëse ngrihet prej një pale ose proprio motu.²³ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund t'u referohet konstatimeve në vendimet e mëparshme, nëse është e bindur se provat ose informacioni që mbështesin ato vendime mbështesin ende

²⁰ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Nasim Haradinaj's Appeal Against Decision Reviewing Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt"), 9 shkurt 2021, publik, para. 55; KSC-BC-2020-06, IA006/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit), ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 1 tetor 2021, publik, para. 15; KSC-BC-2020-04, F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës) ("Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës"), 22 qershor 2022, publik, para. 19.

²¹ [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19; [First Haradinaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt) para. 55. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-04, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës) ("Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin e Shalës"), 10 shtator 2021, publik, para. 19; KSC-BC-2020-07, F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Hysni Gucati](#), (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucati) 24 shkurt 2021, publik, publik, para. 17.

²² [Second Krasniqi Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit) para. 15; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19.

²³ *Shih* [Second Krasniqi Detention Appeal Decision](#), (Vendimin e Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit) para. 16; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19.

konstatimet e bëra në kohën e shqyrtimit.²⁴ Gjykatëses së Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të bëjë konstatime në lidhje me faktorët që tashmë janë vendosur në vendimin e parë për paraburgimin dhe as të shqyrtojë parashtrime të cilat thjesht përsërisin argumente që tashmë janë trajtuar në vendimet e mëparshme.²⁵

15. Gjykatësja e Procedurës Paraprake po kështu nënvizon se në çdo analizë të paraburgimit të z. Kilaj duhet të merret parasysh në masën e duhur prezumimi i pafajësisë së tij.²⁶ Kjo, për pasojë, do të thotë se për vazhdimin e paraburgimit nuk mund të vendoset me lehtësi, dhe se ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i z. Kilaj është i domosdoshëm.²⁷ Kjo do të thotë gjithashtu se ZPS-ja duhet të

²⁴ KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Pjetër Shala's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës"), 11 shkurt 2022, publik, para. 18. Shih gjithashtu [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19.

²⁵ [First Haradinaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Haradinajt), para. 55; [Second Krasniqi Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit), para. 17; [Second Shala Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Shalës), para. 18; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19.

²⁶ Shih KSC-BC-2020-06, F00177/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Application for Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm) ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit"), 22 janar 2021, para. 18; KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Judgment on the Referral of the Rules of Procedure and Evidence Adopted by Plenary on 17 March 2017 to the Specialist Chamber of the Constitutional Court Pursuant to Article 19\(5\) of Law No. 05/L-053 on Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office](#) (Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017 Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar) ("Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017"), 26 prill 2017, publik, para. 113. Ngjashëm, ECtHR, [McKay v. the United Kingdom](#), no. 543/03, Judgment, 3 October 2006, para. 43.

²⁷ Shih, për shembull, KSC-BC-2020-04, F00045/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Pjetër Shala's Request for Provisional Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm) ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës"), 23 qershor 2021, publik, para. 13; [First Thaçi Detention Decision](#), (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 19, me referenca të mëtejshme. Shih gjithashtu, ECtHR, [Merabishvili v. Georgia](#), no. 72508/13, Judgment ("Merabishvili v. Georgia"), 28 November 2017, para. 234.

paraqesë argumente dhe prova konkrete për të vërtetuar se në kohën e shqyrtimit vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm.²⁸

B. DYSHIMI I BAZUAR

16. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar²⁹ se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht sine qua non për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të paraburgosurit.³⁰

17. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, në Vendimin e Konfirmimit u konstatua se, në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Kilaj është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht, tentativë pengimi të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe mosbindje ndaj gjykatës, sipas neneve 401(2) dhe (5), dhe 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi Nr. 06/L-074, përkatësisht, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.³¹ Këto konstatime u bënë bazuar në standard më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.³² Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i shfuqizonin këto konstatime.

²⁸ [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19.

²⁹ *Shih* Nenin 19(1) (1.9) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Kodi nr. 08/L-032 ("KPPK"). *Shih*, në mënyrë të ngjashme nenin 5(1)(c) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër të tjera, në çështjet gjyqësore të GJEDNJ-së, [Fox, Campbell and Hartley v. United Kingdom](#), nos 12244/86; 12245/86; 12383/86, Judgment, 30 August 1990, para. 32; [Erdagöz v. Turkey](#), no. 21890/93, Judgment, 22 October 1997, para. 51; [Ilgar Mammadov v. Azerbaijan](#), no. 15172/13, Judgment, 22 May 2014, para. 88; [Selahattin Demirtaş \(No. 2\) v. Turkey](#), no. 14305/17, Judgment, 22 December 2020, para. 314.

³⁰ [First Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 14. *Shih gjithashtu*, ECtHR, [Merabishvili v. Georgia](#), para. 222.

³¹ Vendimi i Konfirmimit, para. 313(d).

³² *Shih* Vendimin e konfirmimit, para. 43. *Shih gjithashtu*, [Decision on Arrest](#), (Vendimin për Arrestim) para. 43; [First Review Decision](#), (Vendimin e Parë të Rishikimit), para. 14. *Shih ngjashëm*, [Second Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 22; [Sixth Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 24.

18. Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt në thelb kundërshtojnë bazën provuese për akuzat e konfirmuara dhe themelësinë e provave të ZPS-së, duke pasur parasysh materialet e nxjerra në përputhje me rregullat 102 dhe 103 të Rregullores.³³ Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se vendimi i rishikimit të paraburgimit nuk është forumi i duhur për të kundërshtuar provat mbi të cilat mbështeten akuzat e konfirmuara. Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se nuk mund të pritët që, në kontekstin e rishikimit të paraburgimit sipas nenit 41(6) të Ligjit, ajo të shqyrtojë themelësinë e çështjes, cilësinë dhe fuqinë e provave të nxjerra nga ZPS-ja për përgatitjen e gjykit, që janë aspekte për t'u diskutuar në gjykim.³⁴

19. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojta e Kilajt nuk ka vërtetuar se ka ndryshim të rrethanave që do të zhvlerësonin konstatimin e saj të mëparshëm lidhur me ekzistencën e dyshimit të bazuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.

20. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Kilaj ka kryer vepra penale të përfshira në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.³⁵

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

21. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlegjin heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të

³³ Shih më lart para. 7.

³⁴ Shih [Kilaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimin e Apelit të Kilajt mbi Paraburgimin) para. 41; KSC-BC-2020-06, IA008/F00004/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Kadri Veseli's Appeal Against Decision on Review of Detention](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit), 1 tetor 2021, publik, para. 23.

³⁵ Shih ngjashëm, [First Review Decision](#), (Vendimin e Parë të Rishikimit), para. 15; Vendimi për Paraburgimin në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 123, rreshtat 14-18.

specifikohen me hollësi.³⁶ Në këtë aspekt, neni 41(6)(b) i Ligjit pasqyron parimin se vazhdimi i paraburgimit të një personi mund të përligjet vetëm kur ka tregues konkretë të një nevoje të njëmendtë të interesit publik, që peshon më shumë se e drejta për liri e personit.³⁷ Rrjedhimisht, kur merr vendimin në lidhje me vazhdimin e paraburgimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të mbështetet në arsyetim dhe arsye konkrete në lidhje me çështjen.³⁸

22. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se, bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”³⁹ se ekziston ndonjë prej rreziqeve të parapara në secilin prej tre nënparagrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.⁴⁰ Me fjalë të tjera, standardi që duhet të zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.⁴¹ Gjykatësja e Procedurës

³⁶ *Shih* nenin 19(1.31) të KPPK-së, i cili përkufizon termin “artikulueshëm” si: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”. *Shih, për shembull, First Shala Detention Decision*, (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 16; KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Decision on Kadri Veseli's Appeal Against Decision on Interim Release* (Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm) (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*”), 30 prill 2021, publik, para. 15, 18.

³⁷ *SCCC 26 April 2017 Judgment*, (Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 Prillit 2017), para. 113.

³⁸ *SCCC 26 April 2017 Judgment*, (Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 Prillit 2017), para. 115; *First Shala Detention Decision*, (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 16; KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Interim Release* (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm), (“Vendimi e Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*”), 30 prill 2021, publik, para. 22. *Shih gjithashtu ECtHR, Khudoyorov v. Russia*, no. 6847/02, Judgment, 8 November 2005, para. 173.

³⁹ *Shih* pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

⁴⁰ *Shih ngjashëm, First Shala Detention Decision*, (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 16; *Second Shala Detention Decision*, (Vendimin i Dytë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 24. *Sixth Shala Detention Decision*, (Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 26. *First Thaçi Detention Decision*, (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e *Thaçit*) para. 20, me referenca shtesë.

⁴¹ *Shih ngjashëm, First Veseli Detention Appeal Decision*, (Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*) para. 17; *First Shala Detention Decision*, (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e *Shalës*) para. 16.

Paraprake gjithashtu vëren se këto arsye janë alternative, dhe se mjafton ekzistenca e një arsyeje për të vendosur për domosdoshmërinë e paraburgimit.⁴²

23. Sa i përket llojit të vlerësimit sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, ndonëse përfshin një element të kompetencës diskrecionale,⁴³ vlerësimi duhet të mbështetet në faktet e çështjes dhe duhet të kryhet mbi bazë individuale, duke mbajtur parasysh rrethanat personale të personit të paraburgosur.⁴⁴ Kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson faktorët përkatës, ai nuk i vlerëson ata në mënyrë fragmentare, por peshon të gjithë faktorët relevantë të marrë së bashku.⁴⁵

24. Së fundi, në lidhje me arsyet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se mjafton që rreziqet mund të materializohen si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të personit të paraburgosur, por nuk është e nevojshme që ato të kryhen fizikisht nga ai.⁴⁶

1. Rreziku i arratisjes

25. Në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se vlerësimet e bëra në Vendimin e Parë të Rishikimit janë ende të vlefshme, përkatësisht se: (a) Z. Kilaj ka motivin të arratiset duke pasur parasysh: (i) peshën e veprave penale për të cilat akuzohet; (ii) njohurinë që ka për

⁴² Shih gjithashtu, [Kilaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimin e Apelit të Kilajt mbi Paraburgimin) para. 17; Ngjashëm, [First Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 20; [First Thaçi Detention Decision](#), (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 25.

⁴³ Shih gjithashtu, [Kilaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimin e Apelit të Kilajt mbi Paraburgimin) para. 16. Shih ngjashëm, [First Thaçi Detention Decision](#), (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 21, me referenca të mëtejshme.

⁴⁴ Shih [First Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 17; [First Thaçi Detention Decision](#), (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 21, me referenca të mëtejshme. Shih ngjashëm, ECtHR, [Aleksanyan v. Russia](#), no. 46468/06, Judgment, 22 December 2008, para. 179.

⁴⁵ Shih [First Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 17; [First Thaçi Detention Decision](#), (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 21, me referenca të mëtejshme.

⁴⁶ [First Shala Detention Decision](#), (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 19; [First Thaçi Detention Decision](#), (Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 24.

provat e paraqitura nga ZPS-ja në mbështetje të tyre; dhe (iii) mundësinë e një dënimi të lartë nëse shpallet fajtor;⁴⁷ dhe (b) ai ka mjetet dhe mundësinë për t'iu shmangur drejtësisë. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushton rëndësi faktit se z. Kilaj vijon të njihet gjithnjë e më shumë me provat që mbështesin akuzat, si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të tyre.⁴⁸

26. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbetet e mendimit se, pavarësisht vlerësimeve në favor të z. Kilaj sa i takon jetës familjare të rregullt dhe lidhjeve me komunitetin në Kosovë, vullnetit të tij për të bashkëpunuar me ZPS-në ditën e arrestimit, dhe respektimi i pretenduar i kushteve të mëparshme për lirim të vendosura ndaj tij,⁴⁹ këta faktorë zvogëlojnë vetëm pjesërisht por nuk eliminojnë rrezikun e arratisjes, veçanërisht në këtë fazë kur ndaj tij janë konfirmuar akuza konkrete.⁵⁰

27. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që tregon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Kilaj të arratiset.

2. Rreziku i pengimit të ecursisë së procesit të DHS-së

28. Sa i takon rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se konstatimet e bëra në Vendimin e Parë të Rishikimit janë ende të vlefshme, përkatësisht (i) gatishmëria që z. Kilaj ka

⁴⁷ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit) para. 20. Shih gjithashtu, [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 56-57.

⁴⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se që nga Vendimi i Parë i Rishikimit, ZPS-ja ka bërë katër (4) nxjerrje materialit shtesë sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores. Shih Paketat 11, 17, 19, 21 të materialeve të nxjerra.

⁴⁹ Shih [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 21. Shih gjithashtu KSC-BC-2018-01, F00658/COR/RED, Single Judge, [Public Redacted Version of Corrected Version of Decision on Review of Detention of Isni Kilaj](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hisni Kilajt) ("Vendimi mbi Lirimin me Kusht të Kilajt"), 3 maj 2024 (data e versionit të redaktuar publik të korigjuar, 15 maj 2024), publik.

⁵⁰ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 21; Vendimi për Paraburgim në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 122, rreshti 18 deri në f. 123, rreshti 2; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 59. Shih gjithashtu, [Kilaj Detention Appeal Decision](#), (Vendimin e Apelit të Kilajt mbi Paraburgimin) para. 35.

treguar për të shkelur urdhrat e gjykatës dhe për të ndërhyrë në procese në të cilat nuk është palë, duke vendosur të keqpërdorë informacion në lidhje me dëshmitarë të DHS-së në mospërfillje të plotë të rregullave të konfidencialitetit të DHS-së;⁵¹ (ii) njohja me akuzat ndaj tij dhe provat që i mbështesin ato; dhe (iii) qasja që ai ka në informacion të ndjeshëm që lidhet me dëshmitarë, pas marrjes së aktakuzës së konfirmuar.⁵² Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se procesi i nxjerrjes së materialeve në vijimësi⁵³ shton edhe me shumë rrezikun se ai mund të pengojë procesin.

29. Sikurse është konstatuar më herët, respektimi i pretenduar nga z. Kilaj i kushteve të lirimit nuk i kompenson këto konstatime.⁵⁴ Përkundrazi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se rreziku i marrëveshjes me synim pengimin e procesit gjyqësor është veçanërisht i lartë.⁵⁵

30. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson faktorët e mësipërm në kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve aktualë dhe të mundshëm të DHS-së.⁵⁶

31. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që tregon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Kilaj do të pengojë procesin penal të DHS-së.

⁵¹ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 23. *Shih gjithashtu*, Vendimin për Paraburgim në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 123, rreshtat 3-7; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 61-62.

⁵² [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 23; Vendimi për Paraburgim në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 123, rreshtat 3-7; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 61-62.

⁵³ *Shih më lart* para. 25.

⁵⁴ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 24; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 62.

⁵⁵ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 24; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 61.

⁵⁶ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 25; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 63.

1. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

32. Sa i takon rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera, në këto rrethana, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.⁵⁷ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, sa i takon rrezikut të pengimit të procesit, faktorët relevantë që duhet të merren parasysh janë të njëjtë me ata të përshkruar në paragrafët e mësipërm 28-30. Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se vijon të ekzistojë rreziku që z. Kilaj do të përsërisë veprat penale që pretendohet të ketë kryer.⁵⁸

33. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Kilaj do të kryejë vepra të tjera penale.

3. Përfundim

34. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Kilaj mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, dhe të kryejë vepra penale të tjera, çka e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më poshtë do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm me ndonjë prej kushteve për lirimin e z. Kilaj.

⁵⁷ [First Review Decision](#), (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 27; [Decision on Arrest](#), (Vendimi për Arrestim), para. 22. *Shih gjithashtu*, [First Shala Detention Decision](#), (Vendimin e Parë mbi Paraburgimin e Shalës) para. 39.

⁵⁸ *Shih ngjashëm*, [First Review Decision](#), (Vendimin e Parë të Rishikimit), para. 27; Vendimin për Paraburgim në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 123, rreshtat 3-7; [Decision on Arrest](#), (Vendimin për Arrestim), para. 65.

D. LIRIMI ME KUSHT

35. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, ajo duhet të shqyrtojë të gjitha masat e propozuara dhe ato alternative për parandalimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁵⁹

36. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e saj të mëparshëm se, ndonëse është e vetëdijshme për respektimin e pretenduar nga z. Kilaj të kushteve të vendosura për lirin e tij, ajo ishte e bindur se asnjë prej kushteve të propozuara nga Mbrojtja, përfshirë dorëzaninë në shumën prej 40.000 €, paraqitjen e shpeshtë në policinë e Kosovës, dhe kufizimet e komunikimeve dhe lëvizjeve, nuk mund të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁶⁰

37. Në kundërshtim nga parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt,⁶¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbetet e mendimit se asnjë kusht, i propozuar më parë nga Mbrojtja ose i vendosur proprio motu nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake,⁶² nuk do të zvogëlonte në këtë fazë rreziqet ekzistuese, në veçanti rrezikun që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DH-së ose të kryejë vepra të tjera penale.⁶³ Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se këto kushte: (i) nuk trajtojnë mundësinë që z. Kilaj të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin personave të tjerë ose t'u kërkojë të tjerëve të përdorin mjetet e tyre të komunikimit

⁵⁹ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih [SCCC 26 April 2017 Judgment](#), (Aktvendimin e DHSGJK-së të 26 Prillit 2017) para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, [Buzadji v. the Republic of Moldova](#), no. 23755/07, Judgment ("Buzadji v. Moldova"), 5 July 2016, para. 87; [Idalov v. Russia](#), no. 5826/03, Judgment, 22 May 2012, para. 140.

⁶⁰ Shih [First Review Decision](#), (Vendimin e Parë të Rishikimit), para 32-36; Vendimin për Paraburgim në Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 123, rreshti 22 deri në f. 124, rreshti 1.

⁶¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5, 40.

⁶² Shih KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.

⁶³ Në lidhje me këtë, rikujtojmë se, megjithëse konstatoi se rreziqet vijonin të ekzistonin, Gjykatësi i Vetëm miratoi lirin me kusht të z. Kilaj për të vetmen arsye se në rrethanat e asaj kohe mbajtja e tij në paraburgim nuk ishte më e arsyeshme sipas rregullës 56(2) të Rregullores. Shih [Kilaj Conditional Release Decision](#), (Vendimin mbi Lirin me Kusht të Kilajt) para. 51, 64.

për këtë qëllim; dhe (ii) nuk mund të garantojnë monitorimin efektiv të komunikimeve të z. Kilaj.

38. Sipas Gjykatësës së Procedurës Paraprake, megjithëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, për zvogëlimin sa më shumë që të jetë e mundur të rrezikut të pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera.⁶⁴ Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se Administratorja dhe paneli që kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.⁶⁵

39. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se kushtet e propozuara nga Mbrojtja e Kilajt gjatë paraqitjes së parë për lirin e tij, , ose kushte të tjera të arsyeshme të vendosura nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për të zvogëluar në mënyrë të duhur rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

40. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit, të pasqyruar në

⁶⁴ Ngjashëm, KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), ("Vendimin e Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit"), 27 tetor 2021, publik, para. 68.

⁶⁵ KSC-BC-2023-10, F00165, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Haxhi Shala](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës), 9 shkurt 2024, publik, para. 54.

rregullën 56(2) të Rregullores.⁶⁶ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është faktor që duhet marrë parasysh së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, pasi të jenë shqyrtuar të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.⁶⁷ Megjithatë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se çështja nëse një periudhë kohe e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet teorikisht dhe duhet të bëhet në bazë të fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe në përputhje me veçoritë e saj specifike.⁶⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se ky vlerësim mund të bazohet vetëm në rrethanat në kohën e shqyrtimit dhe jo në atë që mund të ndodhë apo mund të mos ndodhë në të ardhmen e parashikueshme.⁶⁹

41. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Kilaj është mbajtur në paraburgim që nga 2 nëntori 2023 deri më 15 maj 2024 dhe përsëri nga arrestimi i tij më 5 dhjetor 2024; (ii) ndaj tij është ngritur një akuzë për tentativë pengimi të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat ai mund të dënohet, përkatësisht me deri në pesë (5) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim;⁷⁰ dhe (iii) rreziqet nga neni 41(6)(b) i Ligjit (në veçanti,

⁶⁶ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Hysni Gucati's Appeal on Matters Related to Arrest and Detention](#), (Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim) 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73; KSC-BC-2018-01, IA007/F00007/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on the Specialist Prosecutor's Office's Appeal Against Decision on Isni Kilaj's Review of Detention](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt) 13 maj 2024, publik, para. 18.

⁶⁷ [Second Thaçi Detention Appeal Decision](#), (Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin e Thaçit) para. 49, me referenca të mëtejshme.

⁶⁸ ECtHR, [Buzadji v. Moldova](#), para. 90. Në këtë kontekst, çështja nëse vepra penale pretendohet të jetë kryer si pjesë e një grupi është rrethanë relevante për vlerësimin e arsyeshmërisë së vazhimit të paraburgimit. *Shih, për shembull*, ECtHR, [Bak v. Poland](#), no. 7870/04, 16 January 2007, paras 56, 62-63; [Tomecki v. Poland](#), no. 47944/06, Judgment, 20 May 2008, para. 33.

⁶⁹ KSC-BC-2023-10, F00325, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Third Decision on Review of Detention of Haxhi Shala](#), (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës) 5 qershor 2024, publik, para. 47.

⁷⁰ KSC-BC-2023-12, F00055/A01, Prokurorja e Specializuar, [Public Redacted Confirmed Indictment](#), (Aktakuza e Redaktuar Publike e Konfirmuar) 2 dhjetor 2024, publike.

rreziqet e pengimit të procesit dhe kryerjes së veprave penale të tjera) nuk mund të zvogëlohen me asnjë nga kushtet e propozuara ose shtesë për lirim.⁷¹

42. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban gjithashtu parasysh se, që nga Vendimi i Parë i Rishikimit: (i) ZPS-ja ka përfunduar (në pjesë të madhe) nxjerrjen e provave që ka në zotërim, sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores⁷² dhe ka nxjerrë materiale të tjera sipas rregullës 103 të Rregullores;⁷³ (ii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka nxjerrë Vendimin Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve me Dëshmitarët ku miraton masa dhe ndalime ligjore të caktuara që kanë të bëjnë me trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontaktet me dëshmitarë ose viktima në këtë ose në çështje të tjera gjyqësore;⁷⁴ (iii) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e saj të parë sipas rregullës 102(3) të Rregullores⁷⁵ dhe, siç kërkonte Mbrojtja, ka nxjerrë një numër materiale; ⁷⁶ (iv) kryerja e hapave hetimorë të mbetur vijon në mënyrë të rregullt;⁷⁷ dhe (v) Paneli i Gjykatës së Apelit ka lëshuar vendimin në lidhje me apelin e ZPS-së kundër Vendimit të Konfirmimit.⁷⁸ Rrjedhimisht, procesi po avancon me shpejtësi.

43. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu ka mbajtur parasysh parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt se koha që z. Kilaj ka kaluar në paraburgim me

⁷¹ *Shih më lart* para. 37.

⁷² *Shih* Paketat 11, 17, 19 dhe 21 të Materialeve të Nxjerra; Përgjigjja e ZPS-së, para. 8. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, F00100, Pre-Trial Judge, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#), (Vendim Kornizë për Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me to) 20 dhjetor 2024, publik, para. 45, 104(c), (e) (ku caktohet data 17 mars 2025 si afat për nxjerrjen e këtyre materialeve); F00226, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në përputhje me F00100* ("Përditësim i ZPS-së në lidhje me hetimet"), 17 mars 2025, konfidenciale, para. 16 (ku kërkohet leje për nxjerrjen e dy (2) materialeve të mbetura sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores).

⁷³ *Shih* Paketat 10, 18, dhe 23 të Materialeve të Nxjerra.

⁷⁴ KSC-BC-2023-12, F00173, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë*, 11 shkurt 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 11 mars 2025, [F00173/RED](#).

⁷⁵ *Shih* KSC-BC-2023-12, F00185, Prokurorja e Specializuar, [Prosecution Rule 102\(3\) Notice](#), (Njoftim i Prokurorisë sipas rregullës 102(3)), 17 shkurt 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷⁶ *Shih* Paketat 13-16, 20, 22 të Materialeve të Nxjerra; Përgjigjja e ZPS-së, para. 8.

⁷⁷ Përditësim i ZPS-së në lidhje me hetimet", para. 2-15.

⁷⁸ KSC-BC-2023-12, IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [IA002/F00012/RED](#).

gjasë është më e gjatë se dënimi që mund të jepet në rast se ai shpallet fajtor.⁷⁹ Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se krahasimi që Mbrojtja e Kilajt përpiqet të bëjë me dënimet e shqiptuara ndaj z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari si pjesë e marrëveshjes së fajësisë nga ana e tyre është i pavend. Gjithashtu, përcaktimi i dënimit varet nga shumë faktorë, që duhet të trajtohen dhe balancohen rast pas rasti.⁸⁰ Gjithashtu, mbështetja në të ardhmen në plotësimin e kriterëve nga z. Kilaj për ulje të dënimit të mundshëm, nëse ka, është tejet i hamendshëm. Sikurse u theksua më lart, vlerësimi i proporcionalitetit mund të bazohet vetëm në rrethanat aktuale në kohën e rishikimit dhe jo në atë që mund të ndodhë ose të mos ndodhë në të ardhmen e parashikueshme.⁸¹

44. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka vlerësuar në mënyrë të duhur kohën shtesë që z. Kilaj ka kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Parë i Rishikimit, por gjykon se – kur krahasohen me faktorë të tjerë të përshkruar më lart – paraburgimi i tij mbetet proporcional.

45. Gjithashtu, sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Kilaj do të rishikohet në mënyrë të rregullt pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin ose në çdo kohë, në bazë të një kërkesë apo proprio motu, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.

46. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se z. Kilaj nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullore.

⁷⁹ Shih më lart para. 7. Shih gjithashtu, Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 25-29.

⁸⁰ Shih KSC-BC-2023-10, F00693/RED, Trupi Gjykues I, [Public Redacted Version of Reasons for the Decision on the Plea Agreements](#), (Version i Redaktuar Publik i Arsyeve për Vendimin mbi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë), 27 shkurt 2025, para. 69 e në vijim.

⁸¹ Shih më lart para. 40.

V. VENDIM

47. Për arsyet e lartpërmendura Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë versionin e redaktuar publik të F00234 (Përgjigjja e ZPS-së), ose të kërkojnë riklasifikimin e tij si publik deri të **enjten, 10 prill 2025**;
- c. **URDHËRON** z. Kilaj që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri të **hënë, 5 maj 2025**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- d. **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Kilaj vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Kilaj deri të **mërkurën, 14 maj 2025**, dhe z. Kilaj që, nëse dëshiron, të dorëzojë përgjigjen e tij deri të **mërkurën, 21 maj 2025**.

_____/nënshkrim/____

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E hënë, 7 prill 2025

Në Hagë, Holandë.